

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"MASTER CRANE" SH.P.K.

Sot, më datë 14/06/2023

Z. Elton Nexhipi i datelindjes 08/04/1978, lindur ne Durres dhe banues ne Durres, me zotesi te plote per te vepruar, i pajisur me Karte identiteti me ID 038260608 dhe Nr.personal H80408093Q.

Ka përpiluar këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare "MASTER CRANE" SH.P.K., me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria Tregtare "MASTER CRANE" SH.P.K., themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", (këtu e më poshtë Shoqëria).

Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

NENI 2

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin "MASTER CRANE" SH.P.K. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë është:

Punime me vinç dhe autovinça me qira të të gjitha llojeve.

Transport mallrash brenda dhe jashtë vendit. Transport mallrash me mjete jashtë normave.

Tregtim, mallra të ndryshme industriale, ushqimore, konfeksione, bujqësore, drusore, mobileri, pajisje e makineri të ndryshme, etj.

Import - eksport makineri dhe pajisje që përdoren për ndërtim.

Te kryeje blerjen, shitjen, ndertimin, administrimin dhe shkembimin e pasurise se palevizshme

Për realizimin e qëllimit të saj shoqëria mund të bashkëpunojë me çdo person fizik apo juridik në çdo mënyrë që e gjykon të dobishme.

Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj aktiviteti të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat e dispozitat në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse të lëshuara nga organet kompetente të fushës.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Shoqëria ka seline ligjore:

Durrës, Lagjia Nr. 14, Shkozë Rruga " Bajram Tusha ", Z.K. 8515, Godinë me Nr.pasurie S/3019.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie në lekë. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Leka dhe përbëhet nga 1 (nje) kuote.

2) Z.Elton Nexhipi është zoterues i 1 kuote me 100% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë në vlerën 100.000 leke.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i papërcaktuar dhe fillon me regjistrimin e saj në QKB.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga një Administrator, i cili do të zgjidhet për një afat 5 vjeçar, me të drejtë riemerimi. Administratori i Shoqërisë do të jetë Znj.Fjorinda DASHI e datelindjes 20.05.1994 pajisur me Kartë identiteti me Nr. J45520084T

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori, i cili do të ushtrojë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ortaku themelues mund të vendosi me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 9

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 10

Ortaku detyrohet të ruajë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdurojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 11

Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortaket e Shoqërisë. Cdo gjë që nuk është parashikuar në Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozita ligjore në fuqi.

ORTAKU THEMELUES

Eltion Nexhipi

Eltion Nexhipi

